



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10932 prot.

Shkodër, më 30 . 5 . 2025

VENDIM

Nr. 30, datë 29.05.2025

**“PËR NJË SHITESË NE VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SË SHKODRËS.”, TË NDRYSHUAR DHE
DETAJIM TË FONDEVE SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 5 DATË 19.12.2024 TË
MINISTRISË SË FINANCAVE”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; VKM-së Nr.649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”; VKB-së nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Financave nr.17526/2 prot., datë 23.12.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024”, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër prej 40,000,000 lekë për krijimin e kushteve për pushuesit në plazhin publik të menaxhuar. Burim financimi është

fondi shtesë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme sipas shkresës nr. 17526/2 Prot., datë 23.12.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024” të Ministrisë së Financave. Ky aktivitet do të përfshihet në programin P.AC141.Q3.O1.A15 “Krijimin e kushteve për pushuesit në plazhet publike të menaxhuara” përkatësisht transfertë 40,000,000 lekë Artikulli 604, për Sh.a. me NIPT M36924003O, si shtesë kapitali, sipas fishës bashkëngjitur:

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 28 vota

Vota Pro	28
Vota Kundër	10
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.05.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

